

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nënkryetari i PD - Këllçi: Siguria kombëtare nuk ka qenë kurrë kaq e shpartalluar! Qeveri teknike, zgjed hje të reja
ADRESA	https://www.syri.net/politike/918647/kellici-siguria-kombetare-nuk-ka-qene-kurre-kaq-e-s-hpartalluar-qeveri-teknike-zgjedhje-te-reja/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 19:04:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 11:43:30 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3b9b6e4e94cbc272f6f5df7b5efbc7872039a23278ab234206b522edf3ffec99
TEKSTI	b65a451c899e24992dd59a8c7f9e93f91f1e78269b2cac1194c6ec70ad0c8977
PAMJA	97c48171406fbad929dc2b2f6d5db87e8b72d815b2a16759d05c1807683bed08

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	edc86e4e0a81a2f064f648ddb74611bfc61a6a02c055cb067f5fab04832be599
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/edc86e4e0a81a2f064f648ddb74611bfc61a6a02c055cb067f5fab04832be599>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**ENVER BYTYÇI**Vendimi i Hagës dhe raporti
ynë me të vërtetën!**ENVER ROBELLI**Qëndrimi i Zagrebit dhe
heshija e Tiranës

LAJMI I FUNDIT

LIVE-Protesta e 116-të/ Shqiptarët në revoltë kundër qeverisë: Rama jep dorëheqjen**më të lexuarat**VIDEO-'Janë 3 orë përgjime'/ Ahmetaj:
Javën tjetër do publikojmë edhe dy
pasazhe të tjera. Monaco ...Ura shembet 1 javë pas inaugurimit/
Vata: 40 mln lekë nga paratë e qytetarëve
të hedhura në lumëProtesta e 53-të në Divjakë/ Banorët
vijnë qëndresën kundër propozimit të
PS për bashkimin me LushnjënProtesta e 114/ Mbyllen fjalimet para
Kryeministritë, qytetarët nisin
marshimin: Rama jep dorëheqjen'Rusia synon përçarjen'/ Burimi: Sulmet
hibride për të sjellë në pushtet forcat që
nuk ndihmojnë UkrainënVIDEO-'Hajde të tregoj unë ty'/
Përplasja me Ramën në avion, i ri: Më

Këlliçi: Siguria kombëtare nuk ka qenë kurrë kaq e shpartalluar! Qeveri teknike, zgjedhje të reja

13:43, 23/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Nënkryetari i Partisë Demokratike, Belind Këlliçi, ka reaguar përmes një postimi në Facebook pas zhvillimeve të fundit që lidhen me drejtuesit e institucioneve të sigurisë dhe hetimit e drejtësisë. Këlliçi ngre akuza të forta ndaj qeverisë Rama, duke deklaruar se skandalet që kanë prekur institucionet kryesore kanë shkaktuar një krizë të thellë besimi dhe kanë dëmtuar, sipas tij, sigurinë kombëtare dhe marrëdhëniet e Shqipërisë me partnerët.

Duke iu referuar hetimit ndaj kreut të SHISH, akuzave të ngritura në lidhje me Ministrinë e Mbrojtjes dhe hetimeve që prekin institucione të tjera, Këlliçi pyet se si mund t'u besojnë qytetarët dhe partnerët ndërkombëtarë institucioneve shqiptare në këto kushte. Në përfundim, ai kërkon një "zgjidhje urgjente politike", duke propozuar qeveri teknike dhe zgjedhje të reja.

Reagimi:

Kush i beson më Shqipërisë, me këtë Kryeministër, me këta drejtues?! Me kreun e SHISH në arrest për përkrahje të autorit të kimit dhe nxjerrje informacioni, me Ministrin e Mbrojtjes nën dyshime serioze dhe përgjime të bëra publike për trafik armësh dhe vegël e njeriut të punëve të pisëta, Ron Yeffet, me drejtues policie nën kontroll e hetim, me

AKSH-in grup të strukturuar kriminal, siguria jonë kombëtare nuk ka qenë kurrë kaq e shpartalluar! Kolonat që mbajnë shtetin janë goditur rëndë dhe pa mundësi rikuperimi. Kemi të bëjmë me institucione të paralizuar.

Jo vetëm nuk përmbushen funksionet kryesore, por skandalet e inkriminimit kaq të

madh, kanë shkaktuar një krizë të fortë besimi në shoqëri e më tej.

Cili qytetar mund t'i besojë më SHISH apo Policisë së Shtetit, apo autoriteteve, kur del se krerët e këtyre sektorëve i shërbejnë krimit?!

Cili partner, vend anëtar i NATO apo dhe më gjërë mund t'i besojë qeverisë shqiptare dhe Tiranës në këto kushte?!

Me kreun e Shërbimit Sekret të arrestuar, me Ministrin e Mbrojtjes të implikuar, me Edi Ramën që ka marrë, përzgjedhur e promovuar këta njerëz në këto detyra e që sot nuk mban asnjë përgjegjësi.

Dëmi është shumë i madh. Si në zhvillimet e brendshme ashtu dhe në raportet me partnerët.

Kjo qeverisje, ky Kryeministër nuk mund të vijojnë më. Duhet zgjidhje urgjente politike që Shqipëria të kthehet në shinat e normalitetit.

Qeveri teknike, zgjedhje të reja!

© SYRI.net

Lexo edhe:



'Ministri i krimit'/ I riu: SPAK të mos e lejojë Edi Ramën të bëjë një drejtësi si pazar politik! Nesër te parlamenti



Qytetarët mbyllin fjalimet, nisin marshimin nëpër Tiranë: Rama, jepe dorëheqjen!



'Për 10 ditë Rama do ikë, fjalë burrash'/ Thirrja e nënës për të rinjtë: Mos rrihi në kafe, ejani këtu

kapi për qatë une me unë te zbuluak

Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në pikëpyetje sigurinë kombëtare të Shqipërisë

'S'ka normalitet për situatën ku ndodhemi', Këlliçi: Të gjithë e kanë pranuar skandalin e Roni Yeffet, Rama jo!

'Rama, një bandit që vjedh i pashqetësuar', Blushi: 'KAYO' e rivërtetoi se shteti është mafie sot!

TË NGJASHME



Vlora Hyseni e arrestuar/ Demiraj: Duhej mbledhur Këshilli i Sigurisë Kombëtare! Në SHBA janë të skandalizuar



VIDEO- 'Po kontrollohen faktet'/ Çela zbulon detaje nga dokumentari austriak për korrupsionin në Shqipëri



Berisha: Vetëm demokratët mund t'i japin goditjen përfundimtare këtij regjimi! Pa largimin e Ramës, Shqipëria vetëm do rrokulliset



'Rama jep dorëheqjen'! – Nis marshimi i qytetarëve nga sheshi 'Skënderbej' drejt Kryeministrit



Berisha: Mbështetja e protestës qytetare, detyrë madhore e PD! Duhet të bëjmë çdo gjë për ripërtëritjen e partisë



VIDEO/ Berisha: Bojkoti do ishte avantazh për Ramën, ne do i japim atij përgjigjet më të forta në parlament



'Rama jep dorëheqjen'! - Shqiptarët në revoltë kundër qeverisë: Shteti ka rënë

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MIQDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do t'i gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net